

AKT THEMELUES

I SHOQERISE TREGTARE PRIVATE

“G&G Albania”

Unë Geris Hysenllari, i biri i Nazmiut, dtl 18.03.1980, me numer personal I00318065F, Banues Rr: Memo Meto, Pallati 59/1 shk 1, ap 17, Tirane

Mbështetur në Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ” dhe në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, sot më datë 05.01.2023, krijojme shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar “G&G Albania”, me aktin themelues të saj si vijon :

FORMIMI

NENI 1

Formohet shoqëria private e quajtur “G&G Albania” Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

SELIA E SHOQERISE

NENI 2

Selia e shoqërisë tregtare private “G&G Albania”. do të jetë :
Njesia bashkiake nr 8, Rruga Memo Meto, Ndertesa 54, Hyrja nr 1, Ap 1, Tirane
Ajo mund te çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratim të organve kompetente edhe jashtë vendit.



Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, dege, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e ortakut themelues të saj.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 3

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj në fushën e:
Ndertimit të objekteve civile dhe industriale, Shërbimeve në ndërtim
Import-eksport, shitje me shumicë dhe pakice materialeve të ndërtimit, pajisjeve dhe materialeve elektrike, hidraulike etj. Tregtimit me shumicë e pakicë dhe import-eksport të mallrave industriale, ushqimore, lëndë të para. Hoteleri, Bar Kafe Restorant etj.

NENI 4

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të sigurojë mjetet e nevojshme dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj.

KOHEZGJATJA E SHOQERISE

NENI 5

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

KAPITALI I SHOQERISE

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqërisë tregtare private "G&G Albania" do të jetë **100,000** (njqind mijë) lekë. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë mund të ndryshohet, të shtohet apo të pakësohet (por jo nën vlerën e kapitalit themeltar fillestar), sipas vendimit të ortakut themelues të shoqërisë. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm. Kapitali përbëhet nga **1** kuota dhe vlera nominale e një kuote është e barabartë me **100,000** lekë.

Z. Geris Hysenllari zotron 1 kuote me vlere 100,000 leke qe perben 100% te kapitalit themeltar



Kapitali themeltar fillestar mund të shtohet sipas vendimit të ortakeve themelues. Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm.

NENI 7

Ortaku i vetëm duhet të bëjë përpjekje për rritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajë sekretin e saj dhe të mos dëmtojë interesat e personave të tjerë dhe të shoqërisë.

DREJTIMI I SHOQERISE

NENI 8

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, Z. Geris Hysenllari i cili është edhe përfaqësues ligjor i saj. Afati i emërimit të administratorit është për një periudhë kohore prej 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

NENI 9

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakeve themelues të shoqërisë, Z.Geris Hysenllari

NENI 10

Ortaku themelues ka të drejtë të emërojë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale të shoqërisë. Ai ka të drejtë të caktojë financiar, likuidator për problemet e shoqërisë, si edhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre-mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të shoqërisë.

NENI 11

Konfliktet që mund të lindin midis palëve do të gjykohen dhe zgjidhen në zbatim të legjislacionit shqiptar në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 12

Shoqëria ka vulën e saj në madhësi të zakonshme, me tekstin për rrethin e saj.

NENI 13



Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ”.

NENI 14

Ky akt themelimi përpilohet në tre kopje me vlerë të barabartë, nga të cilat njëra depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, njëra në zyrën e Tatimeve dhe kopja e tretë mbahet në dokumentat e shoqërisë tregtare "G&G Albania"

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaket themelues.

ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE

"G&G Albania"

GERIS HYSENLLARI

Geris Hysenllari

